

**BASHKIA TIRANË**  
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Igroup” shpk & “Inerti” shpk,  
Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga “Fadil Rada”, Pallati Daniela, Shkalla 2, Kati 3,  
Apartamenti 9, Nr. pasurie 6/544+2-P, Tiranë.

Procedura e prokurimit: Loti VI “Riforcim i njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Tiranë”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-92420-04-07-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Tender i Kufizuar” me Marrëveshje Kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit, e perzgjedhur në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Udhëzimit Nr. 1, datë 13.02.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, pika 7.1; Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 35/1 si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Neni 41.

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar: Sipas short-listing të pasqyruar në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

1. Operatori ekonomik “Agri Construction” shpk, NUIS K01725001F
2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “BE-IS” shpk & “Ergi” shpk & “2T” shpk, NUIS K71412003A & NUIS K02727229P & NUIS K01731001M
3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Egeu Stone” shpk & “Alb Tiefbau” shpk NUIS L63916002I & NUIS J66703049C
4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Euro-Alb” shpk & “Sireta 2F” shpk, NUIS K66613407H & NUIS K51501008J
5. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Igroup” shpk & “Inerti” shpk, NUIS M01406012K & NUIS K21622001M
6. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Kacdedja” shpk & “Everest” shpk, NUIS K51712017A & NUIS J78311921L
7. Operatori ekonomik “Llazo” shpk, NUIS K24218401K
8. Operatori ekonomik “PE-VLA-KU” shpk, NUIS K61716013M

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazën tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Igroup” shpk & “Inerti” shpk, NUIS M01406012K & NUIS K21622001M  
Oferta ekonomike = 114,406,649.80 (njëqind e katërmbëdhjetë milion e katërqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzetë e nëntë pikë tetëdhjetë) lekë pa TVSH.
5. Operatori ekonomik “PE-VLA-KU” shpk, NUIS K61716013M  
Oferta ekonomike = 114,407,000 (njëqind e katërmbëdhjetë milion e katërqind e shtate mije) lekë pa TVSH

*Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:*

1. Operatori ekonomik “PE-VLA-KU” shpk

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Ofertat e paraqitura nga operatorët e mësipërm ekonomikë janë identifikuar si oferta të pasuksesshme pasi referuar pikëzimit nuk arrijnë pikët maksimale.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve ekonomik “Igroup” shpk & “Inerti” shpk se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me 100 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Përgjegjës, Bashkia Tiranë*, sigurimin e kontratës prej 15 % të vlerës së saj, siç parashikohet në Aktin Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për

përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Neni 43, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 26 / 07/ 2021

Ankesa: Në fazën e parë të procedurës së prokurimit nuk ka pasur ankesa.